



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	23.05.2025
Nga:	ZPP Gentiana Qela
PER:	AAB CONSTRUCTION SH.P.K.
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AAB CONSTRUCTION SH.P.K.” të datës 28.04.2025 kundër njoftimit për kontratë për procedurë të prokurimit me numër 611-25-1200-5-1-1, me titull “ Shtepia e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara [Ndertimi i objektit Multifunksional] R” datës 14.02.2025 , Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “ AAB CONSTRUCTION SH.P.K.” të datës 22.05.2025 kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-1200-5-1-1 me titull “ Shtepia e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara [Ndertimi i objektit Multifunksional] Re datës 27.02.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin për anulim të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik “ AAB CONSTRUCTION SH.P.K.” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Zyra e Prokurimit ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe e refuzon sit e pabazuar për faktin që procedura është korigjuar dhe kriteret e mbetura duke analizuar secilen veq e veq:

Pika 1 : Inxhineri hidroteknik i certifikuar per auditimin e energjise efikase – Eshte kriter i cili mund te plotesohet nga cdo operatore serioz i natyres se punes dhe eshte percaktuar duke u bazuar ne punet qe do te kryhen ne projekt dhe duke marre parasysh qe efikasiteti i energjis eshte tema baze per ndertim e cila duhet te plotesohet gjate ndertimeve te objekteve .

Pika 2 : Bachelor i arteve ne menaxhimin e emergjencave – Eshte pune e ndertimit te larte dhe operatoret ofertues duhet te kene stafe te kualifikuar ne menaxhimin e emergjencave qe parashikohen ne ndertim dhe gjate ndertimit te projektit .

Pika 3 : Nje master i shkencave teknike – drejtimi gjeoteknike nuk eshte kriter kufizues dhe as diskriminues per arsyje se as nuk eshte kerkuar -pervoja vetem diploma dhe kontrata qe eshte i angazhuar ne projekt .

Pika 4 : Secili staf i cili angazhohet ne kete projekt duhet te jete professional dhe per kete kemi kerkuar qe te jete I certifikuar ne profilin e tyre duke mos diskriminuar asnje operatore .

Pika 5 : Tekniku i makineris i certifikuar per kranist ose vinçer nuk eshte kriter kofizues pasi qe certifikimi eshte kerkuar pikerisht ne profesionin e tij dhe profilin e punes per te cilen eshte angazhuar .

Pika 6 : Po ashtu per tekniket llamarine punes , ngjyre punes energji , klimatizim dhe mjedis jane kritere plotesisht te qendrueshme qe kane te bejne me natyren e punes dhe me pozicionet ne paramase te cilat do te ekzekutohen (nuk mund te realizohet projekti pa stafe professional te natyres se njejte te punes) .

Pika 7 – Nje teknik i makinerise drejtimi trafik rrugore – eshte kriter i qendrueshme per arsyje se objekti do te ndertohet afer rruges kryesore dhe duhet te behet menaxhimi i trafikut .

Pika 8 . kerkesa eshte 20 puntor teknik qe mund te sigurohen shume lehte ng ate cilet 5 duhet te jene te certifikuar ne lemin perkatese te profesionit te vet – kriteri eshte plotesisht i qendrueshme .

Pika 9 : Sa i perket paisjeve te gjitha jane me natyren e punes se ndertimit dhe te cilat mund te gjinden shume lehte ne tregun e Kosoves pasi qe jane kritere standarde ne Komunen tone dhe deri tani nuk kemi pas probleme ne plotesimin e dosjeve nga ana e Operatoreve ofertues .

Kunder ketij vendimi keni te drejte ankese ne OSHP ne afate prej 10 Dite .